

PARTIA AMBJETALISTE

TIRANE

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

DHE

PASQYRA E FONDEVE TE PERFITUARA DHE

SHPENZIMEVE TE KRYERA

GJATE FUSHATES ZGJEDHORE

PER PERIUDHEN

23 MAJ 2013 - 23 QERSHOR 2013

Tirane,me 28 Tetor 2013

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVAUUR

Drejtuar : Komisionit Qendror te Zgjedhjeve:

Pallati i Kongreseve

Tirane

Partise Ambjentaliste

(Kongresi Lushnjes,P.35,Ap 32)

Tirane

Te nderuar Zoterinj:

Bazuar ne Ligjin 10019 date 29/12/2008 “Kodi Zgjedhor i RSH”i ndryshuar, ne zbatim te Vendimit te KQZ Nr. 752 date 02/08/2013 si dhe Kontraten e Sherbimit Nr.6673 date 02/09/2013 te lidhur me kete institucion ne cilësinë e Ekspertit Kontabël të Regjistruar kemi audituar pasqyrat financiare bashkelidhur që lidhen me financimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushaten zgjedhore, që fillon me datë 22.05.2013 me regjistrimin e Partisë Ambjentaliste në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (si subjekt zgjedhor) dhe mbyllet me datë 22.06.2013 me përfundimin e fushates zgjedhore të 23 Qershor të vitit 2013.

Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Drejtimi mban pergjegjesi per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave ne perputhje me Ligjin Nr. 10019, date 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise” dhe Ligjin Nr.9228 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” date 29.04.2004. Detyra e subjektit zgjedhor është të përgatisë pasqyrat bashkelidhur mbi bazen e arketimeve dhe pagesave.

Pergjegjesia e Audituesit

Pergjegjesia e jone eshte qe bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Auditimin e kemi kryer ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit, referencë të vecantë me SNA 800. Keto standarte kerkojne qe ne te jemi ne perputhje me kerkesat e etikes dhe qe te planifikohet dhe te kryhet auditimi per te marre sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali dhe gabime materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazen e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklarimet në pasqyrat financiare që përfshijnë: Librin e llogarive të subjektit, regjistrin e posacëm të miratuar si model, me vendim nr.266 të KQZ-së, dt.01.06.2009 si dhe pasqyrën e arketim pagesave. Auditimi përfshin gjithashtu, vlersimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vleresimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Ne çmojme se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Pasqyrat bashkëlidhur të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partisë Ambientaliste që fillon me datë 22.05.2013 dhe mbyllet me datën 22.06.2013 është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën e arkëtimit dhe të pagesave, konform ligjit nr.9228 dt.29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Opinion

Sipas opinionit tonë, bazuar në auditimin e kryer, me siguri të arsyeshme, shprehim opinionin se Pasqyrat Financiare të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara (duke patur në konsideratë rekomandimin e pikës III germa B të shenimit) për fushatën zgjedhore të Partisë Ambientaliste që fillon me datë 22.05.2013 dhe mbyllet me datën 22.06.2013 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën e arkëtimit dhe të pagesave, konform ligjit nr.9228 dt.29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” duke dhënë një pamje të vertetë dhe të sinqertë.

Per “LIRENG Auditing” Shpk

Neshat MAZE

Ekspert Kontabel i Rregjistruar

Lic.148 date 21/07/2006

I- INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

I.1 Baza ligjore kryerjen e ketij misioni është marrë në referim të ligjeve:

- Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës se Shqipërisë”.
- Ligji nr.8580, dt.17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar me ligjin Nr.10374, date 10.02.2011.
- Ligji nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, Standartet Ndërkombetare të auditimit dhe kryesisht (SNA 800).
- Ligji Nr. 9228 date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finnciare,,
- Cdo dokument ligjor të marrë prane Partisë Ambjentaliste.

I.2 TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SUBJEKTIN ZGJEDHOR

Subjekti zgjedhor Partia Ambjentaliste Tirane e ka fituar zotësinë juridike për të vepruar,ne baze te Vendimit te Ministrise se Drejtesise.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit nr. 8580, dt.17.02.2000 “Per Partitë Politike”, të Ligjit nr.8788, dt.07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimpruese “, të Ligjit nr.8779, dt.07.05.2001 “Për Regjistrimi e Organizatave Jofitimpruese”, nga statuti i saj dhe legjiacioni ne fuqi.

Subjekti zgjedhor Partia Ambjentaliste Tirane është një organizatë shqiptare e cila e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë.

Organet drejtuese ne udheheqijen qendrore janë:

- Kongresi
- Keshilli kombetar
- Kryesia
- Komisioni Qendror i Kontrollit

Kryetar i partise është zgjedhur z. Nasi BOZHEKU, i cili është i autorizuar të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për aktivitetin normal të Partise Ambjentaliste.

Adresa e partise është në : Rruga. “Kongresi i Lushnjes”, P.35,Shk 2. Kontakte te tjera : Mob. 0682244120.

Politikat operuese

Drejtimi i Partise, ka operuar per kete periudhe qe auditojme ne, ne pajtim me ligjin 10019, date 29.12.2009 “Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise”, ligjin 8580 date 17/02/2000 “Per partite politike” i ndryshuar, dhe ligjin Nr.9228 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat

Financiare” i dates 29.04.2004, dhe ne konformitet aktet nenligjore, me objektin e veprimtarise per te cilin eshte krijuar, dhe programit te caktuar nga organet qendrore.

Te ardhurat Financiare te Partise jane te parashikuara ne statut :

- Kuotat e antaresis partise
- Buxheti i shtetit, sipas ligjit per financimin e partive politike.
- Te tjera

II. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABEL

II.1 Mënyra e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare.

- a) Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar (NKRF), të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin nr.9228 dt. 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finnciare,, dhe Planin Unik Kontabel, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
- b) Pasqyrat e paraqitura në raport janë shprehur në monedhen vendase në Leke.
- c) Rregullat për vlerësimin e kërkesave për arkëtim dhe të detyrimeve. Kërkesat për arkëtim janë të pasqyruara mbi bazën e vlerës së faturave origjinale të lëshuara nga klientet apo të dokumentave të tjerë kontabël. Detyrimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazen e faturave dhe dokumentave orgjinale kontabël.
- d) Rregullat e vlerësimit të likuiditeteve. Gjendjet e likuiditeteve përfshijne gjendjen e parave në arkë dhe në llogaritë rrjedhese në bankë në leke. U kontrolluan veprimet e kryera në arkë dhe bankë dhe u konstatuan se regjistrimet në librat e llogarive dhe në ditarët përkatës ishin kryer sipas normave kontabël.
- e) Të Ardhurat
Të ardhurat regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre nga dontorët dhe perdorimi i tyre është sipas planit të buxhetit të financuar nga projekti.

II.2 ORGANIZIMI I KONTABILITETIT

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat

financiare”. Partia ka ndertuar nje plan të llogarive vetjake në përputhje të plote me Planin Unik Kontabël. Kontrolli i brendshem kryhet nga dega e finances. Kontabiliteti mbahet në menyre manuale.

III - PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE,

A. Te ardhura te perfituara ne shumen 0.00 Leke , te perbera nga :

Nga auditimi rezultoi se Partia Ambientaliste nuk eshte financuar per fushatën e zgjedhjeve per zgjedhjet per Kuvend 2013, siç parashikohet ne nenet 87 e ne vijim te Ligjit 10019 date

B. Te shpenzuara ne shumen110.000.00 Leke , te perbera nga :

- Pode me qera20.000.00 Leke
- Flamuj dhe aksesori60.000.00 Leke
- Karburant30.000.00 Leke

Shumat e mesiperme si per te ardhurat e perfituara dhe te shpenzuara, per fushaten zgjedhore, per zgjedhjet Kuvendore 2013, pasqyrohen sipas deklarates te leshuar nga kryetari i Partise Ambientaliste (bashkelidh).Shuma e shpenzimeve te deklaruar nga Partia Ambientaliste sipas deklarimit jane kryer.Ne lidhje me keto shpenzime rekomandojme qe drejtimi i partise ti siguroj keto dokumenta dhe dhe te kryej arshivimin e ruajtjen e dokumentacionit tatimor.

IV-Gjendja e Likuiditeteve :

Ne mbyllje te fushates zgjedhore gjendja e likuiditeteve ne llogarite bankare dhe ne arke, per ato te celura vetem per fushaten eshte 0.00 Leke.

V- NGJARJE TE MEVONSHME

Nuk ka patur ngjarje te mevonshme qe mund te influencojne ne pasqyrat financiare te mesiperme.

Per “LIRENG Auditing” Shpk

Neshat MAZE

Ekspert Kontabël i Regjistruar

Tirane , me 28 Tetor 2013